



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 28 maj 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua kërkesa e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.

U miratua kërkesa e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW.

U miratua një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.08.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 MW”, i ndryshuar.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW.

U miratua kërkesa e shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 06.11.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 91, datë 02.04.2026, “Mbi licencimin e shoqërisë “DION ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW”.

U vendos fillimi i procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike tek shoqëria “EZ5 Trading” sh.p.k.

U shty vendimmarrja e Bordit lidhur me një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 01.09.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 12 MW”.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW”, i ndryshuar.

U shty vendimmarrja e Bordit lidhur me disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW”, i ndryshuar.

U miratua “Vlerësimi i ERE-s për gatishmërinë e tregut të ditës në avancë në Shqipëri”.

U shty vendimmarrja e Bordit lidhur me miratimin e disa ndryshimeve në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

U shty vendimmarrja e Bordit lidhur me miratimin e “Strategjisë së ERE-s për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorit të energjisë, periudha: 2026 – 2028”.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 275, datë 13.12.2024 nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.